



DFK/DMP  
02

03-3874/13  
14.11.2013



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE PRIZREN/ OSNOVNI SUD U PRIZRENU/ BASIC COURT IN PRIZREN

Nr.474-05/2012

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Divizioni për Kundërvajtje**, me gjyqtarin Gjimshit Galushi, dhe procesmbajtësen Nexhla Vebiqi në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Masar Shala nga Prizreni, për shkak të kundërvajtjes nga neni 5. dhe 6. par.1.3 .si dhe neni 9, të ndëshkuar sipas neni 17.par.1.3 të Ligjit për Deklarim, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, e në bazë të neni 195 të LMK-së, me datën 09.10.2013 merr këtë :

**A K T V E N D I M**

I pandehuri Masar Adem Shala, i lindur me 18.03.1964, në Gjakovë, me vendbanim në Prizren, rr.Tahir Sinani pa nr.

**Ë s h t ë P ë r g j e g j ë s**

Sepse, sipas kërkesës së Agjencionit, e si Zyrtare i lartë publik – deputet në asamble komunale në Prizren, nuk e ka bërë deklarinimin e pasurisë dhe prejardhjen e saj, pranë Agjencisë kundër Korrupsionit - brenda afatit Ligjor (deri më 31.03.2012), edhe pse ka qenë i obliguar,

- me kete veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni 5. dhe 6.par.1.3 të ndëshkuar sipas neni 17.par.1.3 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, e për këtë, duke aplikuar nenin 10 të LMK-së, shqiptohet.

**Q O R T I M I**

Se egzistojnë rrethanat që në masë të konsiderueshme e zvogëlojnë përgjegjësinë e kryersit

Sipas kërkesës së Agjencisë kundër Korupsionit të Republikës së Kosovës - në Prishtinë , me nr.01-1889/2012 të datës 24.05.2012 , u zhvillua procedura kundërvajtëse kundër të pandehurit Masar Shala nga Prizreni , për shkak të kundërvajtjes nga neni 5. dhe 6.par.1.3 të ndëshkuar sipas nenit 17.par.1.3 të Ligjit për Deklarimin , Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik .

Gjendja faktike është vërtetuar në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës , si dhe deklaratës së të pandehurit , i cili në deklaratën e tij ka theksuar se deklarimin e pasurisë nuk e ka bërë, për arsye së gjendjes e rrëndë shëndetësore . Ka theksuar faktin se nga detura e deputetit ishte larguar, për shkak të sëmundjës, mbi 10 muaj , për çka posedon edhe faktin nga mjekt, si nga vendi e poashtu edhe nga mjekt e Turqisë .

Nga të dhënat e parashtruar në kërkesë , vlerësimi të deklaratës së të pandehurit , si dhe vlerësimi të të gjitha provave së bashku dhe secilës veç e veç të bashkangjitura në kërkesë , Gjykata konstatoi se i pandehuri në fjal vërtet nga gjendja e rrëndë shëndetsore , e po ashtu edhe nga mungesa e tij , nuk ka mundur vërtet të përmbush obligimin ndaj agjencionit mbi deklarimin e pasurisë .

Duke pasur parasysh rethanat nga neni 7 të LMK-së , se i njejt ka patur sjelljet korekte , e poashtu faktin të gjendjes shendetësore të tij , egziston arsya pse i pandehuri nuk e ka përmbush obligimin e vet, e konform nenit 10 të LMK-së , i ka shqiptuar qortim , se egzistojnë rethanat që në masë të konsiderueshme e zvogëlojnë përgjegjësinë e kryersit , se përpara çdo vit me kohë agjencionit i është përgjigjur , me bindje se edhe me këtë llojë të denimit do të arihet qëllimi i ndëshkimit , që i njejt në të ardhmen të mos kryej kundërvajtje të tilla apo të ngjajshme , dhe të respektoj afatin ligjore .

Vendimi mbi shpenzimet gjyqsore është marrë konform nenit 113 të LMK-së .

Me sa u cek me larte, u vendos si ne dispozitiv te aktvendimit .

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Divizioni për Kundërvajtje**  
**Nr.474-05/2012, datë: 09.10.2013**

Gjyqtari  
Gjimshir Galushi

**UDHËZIMI JURIDIK** : Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur , mund të ushtrojë ankesë , Gjykatës së Apelit - Divizionit për Kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditëve , pas marrjes të të njejtit , përmes kësaj Gjykate .